

"Berberi i Seviljes" një burim formash regjisoriale. Atë që synoi posaçërisht për Shqipërinë i frymëzuar nga fotot e Marubit, regjisori francez Eric Vigner e realizoi në një moment të caktuar të takimit të dy kulturave, dramaturgjisë franceze dhe traditës shqiptare.

Berberi ceremonial

ELSA DEMO

Trebicka ka fituar njëzet vite më pak, Helidon Fino me fustanellë dhe Neritan Liçaj me bollkat e zeza duken si të dalë nga miniaturat otomane, ndër-sa Xhuvani më skenike se kur-re me fustan të zi dhe krehjen e mbledhur pas qafës. Pamë më shumë se gjysmën e aktit të parë të "Berberit të Seviljes" të Bomarsheës dje në Teatrin Kombëtar me regji të Eric Vigner-së, aq sa për të pohuar se regjisori francez premtion në premierën e nesërme një spektakël modern dhe klasik, shqiptar dhe evropian. Çfarë kish-te shprehur në fillimet e punës, Vigner e ka bërë vepër. Duket një "Berber Sevilje" në formën e teatrit si ceremonial. Është herët të flitet një ditë para për lojën e aktorëve dhe sidomos për ritmin e komedisë që është më e shkurtër dhe e përshtatur nga origjinali. Por ajo gjysmë e punës e treguar dje na bën kurioz se si do të rrinë deri në fund personazhet e veshur me fustanellat e bardha të jugut, e folura, e kënduara, e kënduara dhe prapë e folura, muzika e Fatos Qerimit që ka kompozuar enkas për "Berberin", dashuria mes Kontit Almaviva dhe Rozinës, besnikëria e Figarosë ndaj të zotit dhe lufta me dhëmbë e Bartolos për të mbajtur në errësirë një trëndafil. Vigner i ka dhënë ceremonial, për shembull, situatës së rinjohjes së kontit dhe shërbëtorit. Vallja, nëse mund të quhet e tillë, vështrimi i ngrirë për disa minuta i dy miqve dhe sjellja rrotull me kërcime dhe gje të prera, që të kujtojnë përballjen e burrave në vallet dyshe shqiptare, është një ritual i vërtetë. Këto së bashku me këngët e personazheve janë elementë të një teatri që regjisori francez e përcaktoi dje si muzikal. Është hera e parë për vetë Vigner-në kjo vënie

skenike që ndoshta ka për t'u shfaqur një ditë në Francë, siç tha dje duke bërë një gjysmë premtimi atasheu i Ambasada-s Franceze. Regjisori nga ana tjetër nuk është i sigurt nëse do ta rikrijonte me ndonjë teatër tjetër këtë Bomarshe të Tiranës. Kjo jo vetëm për

faktin se "Berberi i Seviljes" është një burim formash regjisoriale, por ç'është më e rëndësishmja, atë që synoi posaçërisht për Shqipërinë i frymëzuar nga fotot e Marubit, Vigner e realizoi në një moment të caktuar të takimit të dy kulturave, dramaturgjisë

franceze dhe traditës shqiptare. Për këtë, Eric Vigner duhet çmuar.

Një nga protagonistët e shfaqjes Helidon Fino, në rolin e Figarosë, rezervon surpriza për spektatorin e teatrit, pak nga të cilat i zbulon te kjo intervistë.



Në foto: Aktorët Roland Trebicka dhe Helidon Fino (poshtë) në provat e "Berberit të Seviljes" Majtas, Neritan Liçaj dhe Luiza Xhuvani Foto: Armand Abazi/ALNA

KOSTUMOGRAFIA

Nga stili i mbretit Zog tek zonjat e Gjirokastrës

Kostumografia Anila Zajmi ka qenë bashkëpunëtorja më e ngushtë e regjisorit Eric Vigner në këtë takim me traditën shqiptare. Është thënë gjithë ditës dhe se kostumet janë një pikë e fortë që Vigner e shfrytëzon në shfaqjet e tij, aq sa ai krijon një fushë të bardhë skenografie, larg traditës dhe e dendëson skenën pikërisht me kostume dhe ndriçim. Zajmi thotë se në drejtim të kostumografisë gjithçka është krijuar mbi konceptin regjisorial. Gjithë elementët e veshjes janë fund e krye shqiptarë, edhe çizmet e bardha që për një moment duken si një element aristokratik i tepruar. Për këto, për çizmet e Kontit Almaviva (Roland Trebicka) Zajmi i është

referuar një veshje tradicionale të përdorur nga Mbreti Zog. Ndërsa për bollkat e zeza të Bartolos (Neritan Liçaj) kostumografia piktoje i është referuar veshjes së një princit mirditor. Zajmi nuk ka preferencë për krahina të caktuara. Kostumet shqiptare nga veriu në jug janë një minierë fantazie e pasur me detaje nga më të çuditshmet. Kështu për një nga fustanet e Rozinës (Luiza Xhuvani), personazh që ajo e njeht mirë (ka realizuar kostumet e operas), ajo i është referuar xhubletës dhe veshjes së gruas gjirokastrite. "E rëndësishme është që thelbi të jetë shqiptar", thotë Zajmi e qetë që gjithë kjo histori është mbyllur me sukses.

Aktori i Teatrit Kombëtar, Helidon Fino e vlerëson si një frymë të re punën me regjisorin francez Eric Vigner

Kam ankth ç'do më presë pas Figarosë

Ishte i vështirë realizimi i Figarosë?

Vështirësia është komplekse, jo vetëm pse me "Berberin e Sevilyes" vjen një frymë e re

ose një teatër ndryshe. Vetë regjisorit e quan teatër të lirë, ku në bazë të konceptit të tij është loja me mizansenat, me ndriçimin dhe me kostumet, brenda një kuptimi dhe një qëllimi të caktuar dhe të thellë. Aty, gjithësesi, janë marrëdhëniet njerëzore. Eric Vigner na sjell një Figaro që i përket asaj shtresë që ka sjellë revolucionet, që thyen skemat, pavarësisht se mund t'i shërbejë kontëve apo lordëve. Sipas mendimit tim vështirësia ka qëndruar tek fakti që një Figaro i shkruar nga Bomarshe 2 shekuj e gjysmë më përpara, i veshur me veshje kombëtare shqiptare, duhet të jetë një Figaro kontemporan, absolutisht i barabartë me të gjithë. Në fund të fare nuk do ta quaja më shumë një Figaro misterioz se sa një Figaro ndryshe. Për të gjetur një emërues të përbashkët për të gjitha, për kërkesën e regjisorit dhe për mënyrën se si unë e kuptova dhe e lexova veprën në origjinal, pavarësisht nga shkurtimet dhe përshtatja, procesi ka qenë i vështirë. Tani nuk e kam më këtë vështirësi, mendoj se e kam të qartë.

Që në aktin e parë përballimi me një Figaro që sa më shumë u afrohet njerëzve, aq më shumë rritet hijja e tij. Me çfarë qëllimi përdoret ky kontrast?

Kjo gjë ka ardhur spontanisht duke ndërtuar mizansenën, por që thellë-thellë ka qenë në bindjen e regjisorit, në idenë që ka pasur për bardhë e zinë i ndikuar dhe nga kostumet në fotot e Marubit. Por ky i ka parë Figaronë dhe Kontin si dy njerëz të bardhë, si më të çlirët dhe më të lumtur dhe i ka ndërtuar në kontrast me një Bartolo që është më i errët, që e mbyll një Rozinë brenda të cilën e tkurr e lë me dritare mbyllur, pa frymëmarrje. Mendoj se kjo ide është shumë e qartë. Nuk kemi të bëjmë me një Figaro alla Commedia dell'Arte që kërkon marrëdhënie me publikun. Është Figaro ai që ndërton veprën, ai fillon ta shkruajë, kompozon këngën, ngre intrigën për t'i marrë Bartolos Rozinën. Ai di gjithmonë dy hapa mbapa çfarë ndodh, sepse ai e ndërton gjithë skemën, ngjarjen, edhe trillin, edhe gëzimin. Mbaje kjo personifikohet me atë efekt të ndriçimit që ndërkohë që Figaro afrohet



Njeriu gjithësesi bashkohet me këdo, sado i keq apo i mirë, i zgjuar apo i naiv, trillues apo i qetë, apo ekspresiv, diku-diku edhe unë kam elementë të përbashkët me Figaronë

nga publiku për të treguar nëpërmjet gjuhës së komedisë, hijja i rritet nga pas sepse gjithësesi Figaro ky është: jo vetëm mund të dalë i barabartë, por mund të ndalë edhe mbi, përdërisa nuk do të humbasë asgjë.

Kishit edhe një vokal shumë të mirë. Është kërkuar kjo aftësi nga Vigner?

Ka qenë kërkesë e regjisorit i cili fillimisht na pyeti si jeni me këngën, a dini të këndonin. Për një lloj estetike të shfaqjes këngët duheshin realizuar në më të mirën e mundshme. Vetë personazhet nuk janë këngëtarë. Mund të bëjë një përjashtim të vogël Figaro. Në origjinal ai është me kitarë, ai edhe e kompozon këngën, edhe e shkruan, por kjo ishte kërkesë edhe tek personazhet e tjerë. Mbaje një stonaturë diku mund të jetë e qëllimshme. Unë jam përpjekur ta këndoja sa më mirë përdërisa do t'i jap temën e këngës shfaqjes, ritmin fillestar. Ta quajmë një prolog për atë që do të ndodhë. Dua të theksoj se në shkollë kam bërë Korifeun tek "Lisistrata", pra është thjesht një cilësi që tek unë bashkohet me aktrimin.

Ndërsa regjisorit është frymëzuar nga kostumet në fotot e Marubit, ju dhe Roland Trebickën ju shohim edhe në një koreografi valleje burrash.

Regjisorit nuk ka kërkuar posaçërisht një gjë të tillë. Në momentin kur ne përballimi me njëri-tjetrin si dy meshkuj të barabartë, pavarësisht se unë e quaj Imzot Konti Almaviva dhe ai më thotë Figaro, këtu janë dy njerëz që e njohim mirë njëri-tjetrin. Jo pa qëllim Vigner i ka vënë identikë dhe vallja në idenë e tij ka pasur

një energji të caktuar që do të përcaktonte të kaluarën e dy personazheve, të tashmen dhe të ardhmen. Regjisorit ka kërkuar një valle, e ideuar nga Gjergj Prevazi, që mund të shpstatet dhe mund të ketë elementë të folkut tonë.

Monologët në aktin e parë na japin figurën karakteristike të një berberi ku përplasjet gjithë informacioni i mëhallës. Një njeri me 100 veshë dhe me një urtësi të madhe.

Diku-diku janë elementët njerëzorë që bashkohen. Njeriu gjithësesi bashkohet me këdo, sado i keq apo i mirë, i zgjuar apo naiv, trillues apo i qetë, apo ekspresiv, diku-diku edhe unë mendoj të kem elementë të përbashkëta me Figaronë. Në një moment tek monologu, Figaro thotë se i kam rruajtur mjekrën gjithë botës. Si berberi ai ka pasur kontakt me shumë njerëz në jetën e tij, ka qenë në Madrid, ka shkruar, ka taktuar gazetarë, censorë, librarë që i pështriroshin dhe penën. Në tekstin original ai thotë se ka shkruar dhe drama dhe shikon se si njerëzit qeshnin për gjëra që për Figaronë nuk kishin esencë dhe pastaj shihet se si hutoheshin për gjëra që për të kishin esencën më të thellë. Me fjalë të tjera Berberi është një trill artistik që regjisorit na e sjell në mënyrë të tillë për të zmadhuar kontaktin e Figarosë me botën ose siç shprehhet ai: i kam rruajtur mjekrën gjithë botës.

Është hera e parë për ju si aktor i Teatrit Kombëtar që interpretoni në një veprë të këtij dimensionit. Sa ndjeni se jeni zhvendosur nga personazhet tjerë që s'ju kanë marrë dhe aq energji?

Figaronë nuk e kam pasur në listën e personazheve të cilat kam menduar dhe vazhdoj t'i mendoj për karrierën. Edhe veprën e njihja në mënyrë të sipërfaqshme. Që në momentin që rashë në kontakt me "Berberin", isha i prirur të derdhja një energji. Vërtet është një veprë shumë e njohur, ndoshta në vëmendjen e teatrit tonë dhe të regjisorëve mund të mos ketë qenë asnjëherë dhe sidomos mënyra e vënies në skenë më ngacmon më tepër dhe them që kjo mënyrë më ka rezervuar një energji të paparashkuar.

Tek ajo lista që përmendët, cilët personazhe presin?

Më pëlqejnë më shumë personazhet tragji-komikë. Si linjë dhe si zhanër tragjiko-

mizmi më ka pëlqyer gjithmonë. Ka qenë ëndrra e çdokujt dhe besoj se është: nuk e di ku do ta gjej komizmin tek Hamleti, po besoj se do ta gjej, sepse është veçse tragjik, më shumë se sa tragjik. Për të tjerët... për një lloj supersticioni ndoshta më mirë të mos e them listën, sepse kjo është edhe e shkurtër, edhe e gjatë.

Çfarë ndryshon në kulturën e të punuarit me një regjisor të huaj?

Profesioni ynë ka shumë gjëra të përbashkëta në gjithë rruzullin, sepse kalon në një proces që ka ligjet e veta dhe kjo shmanget ato që mund t'i quajmë të panjohura të zanatit ose vështirësi. Ndërsa ajo që e veçon në këtë rast, është stili i këtij individi, ajri i tij për këtë lloj teatri, për këtë lloj koncepti. Me aq sa kemi parë dhe në vepra të tjera që Vigner ka vënë në skenë, ai e ka aplikuar këtë lloj ajri, këtë teatër të lirë ku luan me kostumet, me mizansenën, me veprimet të caktuara. Kjo mendoj se është një eksperiencë e re. Me interes është përballja me një tjetër kulturë. Nuk pretendojmë që e njohim 100% kulturën franceze dhe në të kundërt, por kontakti ndryshon shumë gjëra. Dua të theksoj se në praktikën e Vigner-së procesi i tavolinës është më i shkurtër, pasja e akullit dhe e bardhë e tekstit në kokë dhe pastaj përshtatja gjatë rrugës dhe në mizansenën. Në monologët e brendshëm apo të jashtëm regjisorit Vigner i ka lënë dorë aktorit t'i realizojë. Ndërkohë që në praktikën tonë, është një proces i gjatë në tavolinë për zbërthimin e personazhit, për marrëdhëniet.

Cilët momenti i trembeni?

Do t'u ruhem disa momente që jam pa tekst dhe pa veprim, disa momente kur qëndroj mbapa telajëve dhe vëzhgoj dhe përgjoj se ç'ndodh në shtëpinë e Bartolos për të ndërtuar planin për të ardhmen. Këtyre momenteve do t'u ruhesha shumë.

Do pranoni kollaj një rol tjetër pas Figarosë?

Për mua kjo është një përvojë për frymën ndryshe që vjen në teatër. Sigurisht pas çdo pune, aktori ka kërkesën për hapin tjetër më larg. Hapin e njëjtë nuk do ta pëlqente askush, aq më tepër atë hap që të kthen mbropa. Duke mos e njohur repertorin që do të vijë në Teatrin Kombëtar, kam një lloj ankthi të lehtë si do përballim në punën e ardhshme.

